POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 EURO 2024/ Fillojnë ethet e Shqipëri - Poloni, ndeshja nis me një minutë heshtje! Tifozët grumbullohen në bulevard: Xhamadani vija-vija (VIDEO)

2 'Uragani' kuqezi 'derdhet' në Tiranë: Xhamadani vija-vija, është Kosova është Shqipëria (VIDEO)

3 VIDEO/ Tifozët presin fitoren e Kombëtares, vogëlushi për Report TV: Shënon Bajrami dhe Uzuni

4 U vra në Vlorë, 41-vjeçari në vitet 2000 kishte marrë peng një kambist dhe e kishte ekzekutuar

5 Vëllezërit nga Prishtina mbërritën, 'Plisat' marshojnë drejt stadiumit 'Air Albania' (VIDEO)

Kronikë

Atentati në Vlorë/ Laertjad Kekaj u ekzekutua me 6 plumba në kokë e trup! U qëllua me kallashnikov e pistoletë me silenciator! 28 gëzhoja në vendngjarje

Laertjad Kekaj, 41-vjeç, u ekzekutua mbrëmë në Vlorë teksa lëvizte me motor. 6 plumba i morën jetën. ***Mjeti me targa italiane*** *që u përdor në krim u gjet i djegur bashkë me kallashnikovin në fshatin Kotë. Autorët janë ende të paidentifikuar, janë shoqëruar 8 persona. Hetohet e kaluara e viktimës, i dënuar më parë për vrasje. 41 vjeçari luante lojra fati dhe kishte shumë borxhe.*

■ Vrasja e Laertjad Kekaj në Vlorë, shoqërohen 8 persona në polici
■ 41-vjeçari pasi u qëllua ra nga motori dhe eci për 100 m! Autori e ndoqi nga pas dhe e vrau
■ 41-vjeçari i dënuar më parë për bashkëpunim në një vrasje

Armand Xhelili
10 Shtator, 07:00 | **Përditesimi: 10 Shtator, 14:52**

Share

VLORË- Laertjad Kekaj ishte duke lëvizur me motoçikletë kur në drejtim të tij u zbraz breshëri kallashnikovi dhe pistolete me silenciator nga xhami i pasmë dhe sedilja e parë e një makine tip "Audi" me ngjyrë të zezë. I plagosur, 41-vjeçari ra në tokë por u ngrit sërish me shpresën për t'i shpëtuar atentatit. Eci 100 deri në 150 metra deri pranë Kishës Ortodokse në Vlorë, por njëri prej agresorëve zbriti nga makina, e ndoqi në këmbë dhe e qëlloi sërish, derisa u sigurua ta linte të vdekur. Më pas u kthye në makinën "Audi A6" me xhama të zinj dhe me targa italiane dhe u deshën pak minuta të dilte jashtë Vlorës.

Grupi hetimor bën me dije se bazuar në rrethanat e ngjarjes por dhe të provave të mbledhura deri tani **atentati i ndodhur rreth orës 21:50 të 9 shtatorit 2023** në lagjen "28-Nëntori" ka qenë i mirëorganizuar. Edhe fakti që autorët kishin zgjedhur një makinë si 'Audi A6' të shpejtësisë së lartë për të kryer ekzekutimin është një tjetër provë bindëse se atentati ishte i mirëorganizuar.

[Sh].com

LEXO EDHE:
VIDEO/ Atentati në Vlorë, momenti kur Laertjad Kekaj vrapon t'u ikë ekzekutorëve! Audi kthehet e qëllon sërish

Atentati, plumba në kokë e trup
Mbrëmjen e së shtunës 41 vjeçari po kthehej me motor nga banesa e prindërve në lagjen "Pavarësia" për në shtëpinë e tij në lagjen "28 Nëntori". Plumbat që janë qëlluar fillimisht nga "Audi ë" pranë bibliotekës "Shefqet Musarai" në Vlorë e kanë plagosur duke e rrëzuar nga motori.

Ai ka ecur rreth 100-150 metra deri tek Kisha Ortodokse, por është ndjekur nga autorët. Njëri prej tyre, mendohet se personi që ka qenë në sediljen e parë të Audit, ka zbritur dhe e ka ndjekur deri në afërsi të furrës së bukës dhe e ka qëlluar sërish pranë një furre buke, për t'u siguruar që 41-vjeçari të vdiste.

Ekspertët mjeko ligjorë thanë se 6 plumba kanë përshkuar trupin e Kekës, pjesa më e madhe në kokë.

12 minutat e ikjes me "Audi A6'
12 minuta iu deshën agresorëve të largohen nga lagjja '28 Nëntori' në Vlorë ku kryen ekzekutimin të vijojnë drejt aksit Kotë – Sevastar ku dhe janë ndalur për të djegur makinën me të cilën kryen atentatin.

Kanë qenë banorë të cilët kanë njoftuar për makinën në flakë. Ndërsa policia në pjesën e pasme të saj ka gjetur dhe një kallashnikov që mendohet se është përdorur për të ekzekutuar Laertjad Kekaj. Makina por dhe kallashnikovi janë shkrumbuar. Janë gjetur edhe targat italiane edhe pse janë të dëmtuara nga zjarri.

Pasi dogjën makinën, 3 autorët dyshohet se u pritën nga persona të tjerë për t'u larguar pa lënë gjurmë. Rruga është e vështirë dhe mendohet se autorët janë larguar me fuoristradë drejt Selenicës ose drejt Sevasterit

Tetë të shoqëruar

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Askush nuk është i dyshuar deri më tani. Policia e Vlorës ka shoqëruar 8 persona për t'u marrë në pyetje në lidhje me ngjarjen, pjesa më e madhe e tyre dëshmitarë okularë, por burime pranë bluve bëjnë me dije se deklarimet e tyre nuk kanë ndihmuar hetuesit për zbardhjen e identitetit të autorëve. Gjatë natës janë ngritur pika kontrolli në hyrje/daljet e qytetit të Vlorës dhe në akset "Vlorë-Fier", "Vlorë-Tepelenë" dhe "Vlorë-Himarë" por deri tani nuk ka asnjë të ndaluar.
E gjithë zona është e rrethuar me kamera sigurie, pamjet e të cilave janë sekuestruar dhe po verifikohen për të zbuluar dinamikën e vrasjes si dhe lëvizjet e Audi ë, makinës së autorëve para dhe pas ekzekutimit.

28 gëzhoja
Policia gjeti 28 gëzhoja të kalibrit të ndryshëm, kallashnikovi dhe pistolete, 6 plumbat prej të cilëve e kapën në kokë dhe trup, të cilët rezultuan fatal.

Viktima me precedent të theksuar penal, borxhet
Mbetet i paqartë shkaku i këtij ekzekutimi, por një nga pistat është ajo e hakmarrjes. Viktima mësohet se në të kaluarën ka pasur konflikte dhe rezulton me precedent të theksuar kriminal. Laertjad Kekaj ka qenë i dënuar për bashkëpunim në një vrasje dhe ka vuajtur më shumë se 10 vite burg pasi në fillim të viteve 2000 mori peng një kambist dhe e ekzekutoi dhe vite më vonë është akuzuar edhe për vjedhje me dhunë. Por jo vetëm kaq. Viktima kishte shumë borxhe në lojra fati dhe ka qenë pjesë e grupeve kriminale që mund të kenë marrë pjesë në atentatet të ndryshme të ndodhura ndër vite në Vlorë

Lajm ne përditësim...

1 / 9



Laert Keka

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:42

Atentati në Vlorë, Laertjad Kekaj u qëllua me pistoletë silenciator dhe kallashnikov nga 2 qitës brenda në makinë

Detaje të reja nga ekzekutimi i Laertjad Kekajt ndodhur mbrëmjen e djeshme në qytetin e Vlorës. Burime nga grupi hetimor të cilave i referohet Report Tv bëjnë të ditur se ndaj 41 vjeçarit është qëlluar me dy armë, një pistoletë me silenciator dhe një kallashnikov.

Mendohet se në makinën nga ku është shtënë kanë qenë tre persona. Njëri qitës ka qenë në vend të parë të makinës dhe tjetri prapa, informon gazetari i Report Tv, Armand Xhelili. Mësohet se viktima ka marrë 6 plumba në kokë e në trup.

Rrethanat e ngjarjes nuk janë ende të qarta, por Keka ka qenë duke lëvizur me një motor kur është qëlluar nga mjet me targa italiane pranë bibliotekës në Vlorë. Report Tv ka mësuar se 41-vjeçari pasi është plagosur është rrëzuar nga motori dhe është ngritur në këmbë për t'u larguar. Ai ka ecur rreth 100-150 metra deri tek Kisha Ortodokse, por është ndjekur nga autorët, qe e qëlluar sërish për t'u siguruar që 41-vjeçari të vdiste.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:42

Vrasja në Vlorë, Report Tv sjell pamjet nga vendi ku ndodhi ngjarja! Zona e rrethuar me kamera

Report Tv sjell pamjet nga vendi i ngjarjes ku ndodhi vrasja në Vlorë. Siç shihet edhe nga pamjet, një ditë pas vrasjes, vihet re se zona është e pajisur me kamera sigurie të cilat mund të kenë filmuar makinën e autorëve, që pas vrasjes u largua drejt fshatit Kotë.

Policia e gjeti makinën me targa italiane të shkrumbuar nga flakët, ndërsa brenda saj ishte edhe kallashnikovi me të cilin dyshohet se është vrarë 41-vjeçari Laertjad Kekaj. Autorët janë ende të paidentifikuar, ndërsa 8 persona janë shoqëruar në polici. Kamerat e sigurisë në zonë do të vëzhgohen nga grupi hetimor dhe mund të ndihmojnë në zbardhjen e ngjarjes.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 07:28

DETAJET nga vrasja në Vlorë, 41-vjeçari pasi u qëllua ra nga motori dhe eci për 100 metra! Autori e ndoqi nga pas dhe e vrau



Report Tv sjell detaje të reja nga vrasja e Laertjad Kekajt në Vlorë. 41-vjeçari është qëlluar me breshëri kallashnikovi teksa ecte me motor. Fillimisht ai është qëlluar përpara bibliotekës së Vlorës nga një mjet me targa italiane. Pasi është qëlluar, Keka ka rënë nga motori dhe ka ecur për rreth 100 metra, ndërsa autori e ka ndjekur nga pas edhe është siguruar që ta vrasë. Më pas 41-vjeçari është qëlluar sërish para kishës Ortodokse.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 07:23

Vrasja në Vlorë, 41-vjeçari u qëllua me breshëri kallashnikovi, gjenden 28 gëzhoja në vendin e ngjarjes

Laertjad Kekaj, i cili u ekzekutua mbrëmjen e djeshme në Vlorë është qëlluar me breshëri kallashnikovi. Autori ka dalë nga një mjet me targa italiane dhe e ka qëlluar me kallashnikov. Burime për Report Tv bëjnë me dije se në vendin e ngjarjes janë gjetur 28 gëzhoja, që do të thotë se mbi Kekën është zbrazur një karikatori i plotë.

Mjeti që është përdorur nga autorët, është gjetur i djegur në fshatin Kotë në Vlorë. Ndërkohë, brenda tij është gjetur edhe kallashnikovi që dyshohet se është përdorur nga autori për të ekzekutuar 41-vjeçarin.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 07:17

Vrasja e Laertjad Kekaj në Vlorë, shoqërohen 8 persona në polici



Report Tv mëson se 8 persona janë shoqëruar në polici, pas vrasjes së Laertjad Kekaj i cili u ekzekutua me breshëri kallashnikovi. 8 personat e shoqëruar janë marrë në pyetje për ngjarjen.

Deri më tani, nuk ka asnjë person të dyshuar. Ndërsa mjeti që u përdor në krim është gjetur u shkrumbuar me kallashnikovin brenda në fshatin Kotë në Vlorë.

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: vrasja e laertjad kekajt | policia e vlorës | vrasje | Laertjad Kekaj | Vlore

Komento

Komente

Gripi: 10/09/2023 13:33

I beni gjyqin viktimes sikur e kane pushkatuar me gjyqin e popullit. Veshtire se ky lloj ekzekutimi te kete lidhje me hakmarrje. Policia ne Vlore eshte totalisht jashte funksionit. Sa vrasje jane te pazbuluara ne Vlore?

Përgjigju

> **@Askushi:** 10/09/2023 14:31
>
> Jo o dhjar jo me ngateron me veten. Por tjeter gje po them. Ata qe vrane nuk paskan faj fare apo jane burra me te mire se ky?Ky eshte problemi i ketij populli qe nuk e kupton se ata qe vrasin jane me te keqinj se keta qe vriten. Rri larg problemeve dhe mos ju gezo luftes se ketyre.
>
> **Askushi:** 10/09/2023 14:23
>
> Viktimes ska njeri ti bej gjyqin sepse ja kishte bere vet vetes,si duket ti do kesh zbritur ne Vlore mbas 2010

Askushi: 10/09/2023 13:27

Shyqyr qe spati viktima apo te demtuar se nje karikator kalkashi ne ate ore nuk eshte pak,plot me njerez rrotull. Po ky djali babit e kishte mbyshur kupen qe ne 2000

Përgjigju

Dori: 10/09/2023 13:07

Nuk kuptoj pse gjith kjo zhurme per nje pler me pak o popull....

Përgjigju

Jastiku: 10/09/2023 12:41

Nje malok me pak . Keshtu jane keta , skafiste , hajdute , drogaxhi .

Përgjigju

fidel: 10/09/2023 11:12

per kte e kishin rrahur gaz demin?

Përgjigju

> **teo:** 10/09/2023 15:08
>
> po shkoni mor, ca i keni kto mhb, apo si gazetat tona qe shkrujne ja cfare u diskutua ne mbledhjen super sekrete te KGB. a ke qene aty ti kur u rraf ai?
>
> **Fiu:** 10/09/2023 14:06
>
> Ça lidhje kishte Gaz Demi me këtë?! Si ka qenë ngjarja se na bëre kurioz, duket sikur nuk kanë lidhje me njëri tjetrin!
>
> **O ylli:** 10/09/2023 13:14
>
> Kush e ka rraf gaz demin. Ca vendi.duket e habitshme.
>
> **Ylli:** 10/09/2023 13:00
>
> Kish qene dhe qifja o mret aty me shume "trima" tjere.. ja kishin rraf shokun si legen ne sy.. Po cuditerisht asnje skishte lujt nga tavolina, Nderkohe qe gazi rrihej si vajze e keqe me shpulla..

Bosi: 10/09/2023 10:29

Cam ishte ky?

Përgjigju

> **Edison:** 10/09/2023 12:54
>
> O kinez nuk ishte cam po ishte lab
>
> **Turi:** 10/09/2023 10:57
>
> Kinez

Arbërori: 10/09/2023 10:15

Të gjitha vrasjet është duke i bër policia e pushtetit kriminel !

Përgjigju

> **Mjeksia:** 10/09/2023 11:31
>
> Ilacet ! mos i harro ilacet. Apo i ke marre dhe po bejne efekt
>
> **Tirona:** 10/09/2023 10:50
>
> O rob zoti në çdo artikull shkru shteti e Rama. Shyqyr që spam komentit tat mas neshjes me Çekin se vetëm te Sporti ke bo munges. Meru me nai gjo miko leni ca lajme pa komentu.

birce: 10/09/2023 10:12

Iku nje plere e ngyre.....ne ferr ....

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Mendoni se Shqipëria do të kualifikohet në Euro 2024?

PO | JO | NUK E DI

Lajme të tjera

Me mijëra të huaj vizitojnë qytetin antik të Butrintit! Turistët e mahnitur: Vendi më i bukur në Shqipëri

Limos Didani

10 Shtator, 13:00

Kultivuan kanabis në Lukovë, 2 të arrestuar, 2 në hetim dhe 1 në kërkim! VIDEO teksa kujdeseshin për lëndët narkotike

10 Shtator, 11:22



Atentat në Vlorë, qëllohet për vdekje nga një mjet me targa italiane 41-vjeçari! I dënuar më parë për bashkëpunim në një vrasje (EMRI)

9 Shtator, 21:53

S'ka rrugë, 200 banorë të Janjarit në Konispolit të izoluar: Prej dy vitesh s'kemi as mjek, nuk ka nga të vijë! Kryeplaku: Jemi ankuar në çdo institucion, zero përgjigje

Limos Didani

9 Shtator, 20:49

Pëson defekt treni që transporton naftë bruto në zonën e Petroliferës në Vlorë, bllokohet hekurudha dhe rruga dytësore

9 Shtator, 18:52



I vihet sërish flaka pikës së grumbullimit të mbetjeve në Vlorë, dyshohet për zjarr të qëllimshëm

8 Shtator, 16:13

'Rindërtimi', 14 shkolla në Durrës mësim me dy turne! Në Vlorë më pak nxënës në klasë të parë dhe gjimnaz

Armand Xhelili

Aldo Mustafa

8 Shtator, 16:06

Rruga Orikum-Dukat, ARRSH: Të hënën nis puna me shtresat asfaltike, ja si devijon trafiku

8 Shtator, 15:40

Hedhja e inerteve në Butrint dhe ndërtimet pa leje në Ksamil, arrestohen 2 zyrtarë të Zonave të Mbrojtura në Vlorë! Nën hetim 3 të tjerë

7 Shtator, 20:01

Vrasja në Gjorm të Vlorës, flet kryetari i Shoqatës së të Verbërve: E pamundur që një i verbër të mund të dhunojë! Drejtësia do të thotë fjalën e fundit

7 Shtator, 19:32

'Pushimet e vjeshtës' vazhdojnë në bregdet! Operatorët turistikë: 80% e kapaciteteve të zënë në shtator! Durrësi, Vlora, Saranda në krye të hartës së turizmit

Armand Xhelili

Limos Didani

Aldo Mustafa

7 Shtator, 18:24

VIDEO/ Aksident në aksin Kardhiq – Sarandë, dy mjete përplasen dhe përfundojnë në kanal! Një i plagosur

7 Shtator, 08:06

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje